

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6576
E hënë, 4 prill 2022
çmimi 0.40

Zelensky: Forcat ruse po kryejnë gjenocid në Ukrainë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË MJEKIMIN INTENSIV TË SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS (SHSKUK) NUK KA ASNJË PACIENT ME COVID-19

QETËSOHET SITUATA ME COVID NË KOSOVË, ASNJË PACIENT NË MJEKIMIN INTENSIV



Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të dielën se në Mjekimin Intensiv nuk ka asnjë pacient me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 1 027 testimeve, 19 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Po gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të dielën janë shëruar 33 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 860. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 555

AKTUALE



NË CILAT ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DO TË APLIKOJË KOSOVA PËR ANËTARËSIM? F.6

PO LUANIN BIXHOZ, POLICIA ARRESTON 13 PERSONA NË NJË LOKAL NË PRIZREN F.6

DERI NË 20 GARDË CELSIUS TEMPERATURAT GJATË JAVËS SË PARË TË PRILLIT F.3



EKONOMI



REFORMA SOCIALE, PENG I 47 MILIONË EUROVE F.7

SPORT



NDËRPRERËT DERBI GJILANI-BALLKANI, STIVI FRASHËRI BËHET PËR SPITAL F.6

Veliaj: Presidenti i ri i Shqipërisë duhet të jetë në shërbim të publikut

FAQE 3



PERFORMANCË E SHKËLQYESHME E KADETËVE TË FSK-së NË AKADEMITË USHTARAKE AMERIKANE

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Forcat ruse po kryejnë gjenocid në Ukrainë

KIEV, 3 PRILL - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, akuzoi Rusinë për kryerjen e gjenocidit dhe përpjekjen për t'i eliminuar të gjitha kombet në Ukrainë, një ditë pas zbulimit të varreve masive dhe ekzekutimit të civilëve pranë Kievit.

"Ky është gjenocid. Eliminimi i të gjithë kombit dhe popullit", tha Zelensky për CBS. "Ne jemi qytetarë të Ukrainës. Në Ukrainë kemi më shumë se 100 kombësi. Bëhet fjalë për shkatërrimin dhe shfarosjen e të gjitha këtyre kombësive", tha Zelensky.

Tri ditë pas fillimit të pushtimit më 24 shkurt, Ukraina paraqiti një ankesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë duke akuzuar Rusinë për "planifikim të akteve të gjenocidit".

Zelensky ka folur një ditë pasi e gjithë bota pa pamjet e transmetuara të trupave civile të shtrirë në rrugët e qytetit Buça në afërsi të Kievit, si dhe të raportimit se 280 trupa ishin varrosur në një varr masiv. "Ne jemi qytetarë të Ukrainës dhe nuk duam t'i nënshtrohemi politikës së Federatës Ruse. Kjo është arsyeja pse po shkatërrohem dhe shfarosemi", tha Zelensky. "Dhe kjo po ndodh në Evropën e shekullit 21. Pra, kjo është tortura e të gjithë kombit", shtoi ai.

Zelensky bëri thirrje për një tërheqje të plotë të forcave ruse nga Ukraina, "të paktën në kufijtë e tyre që ekzistojnë para

24 shkurtit, kur Rusia sulmoi Ukrainën". "Nuk mund të ketë asnjë takim derisa bombardimet po vazhdojnë. Pra, së pari armëpushim, pastaj mund të kemi një takim me presidentin rus", tha Zelensky. Miliona njerëz kanë ikur nga Ukraina prej kur presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës.

Boris Johnsoni dënon vrasjen e civilëve në Ukrainë

Kryeministri britanik Boris Johnson ka dënuar ashpër ekzekutimin e civilëve ukrainas, që doli në dritë pas tërheqjes së trupave ruse nga periferitë e Kievit. "Sulmet e neveritshme të Rusisë kundër civilëve të pafajshëm në Irpin dhe Buça janë edhe më shumë dëshmi se presidenti rus Vladimir Putin dhe ushtria e tij po kryejnë krime lufte në Ukrainë", tha Johnsoni në një deklaratë.

Kryeministri britanik premtoi se do të bënte gjithçka në fuqinë e tij, duke u zotuar se Londra do t'i shtrëngonte sanksionet kundër Moskës dhe do t'i rrisë furnizimet me armë dhe ndihmën humanitare për Ukrainën.

Johnson theksoi, gjithashtu, mbështetjen e Britanisë për një hetim të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për mizoritë e kryera në Ukrainë.

"Londra do ta rrisë mbështetjen e saj financiare për hetimin e



gjykatës dhe do të dërgojë hetues specialistë", tha Johnsoni. "Ne nuk do të pushojmë derisa drejtësia të vihet në vend", tha Johnsoni. Komentet e kryeministrit britanik erdhën pasi dhjetëra trupa të pajetë u zbuluan në Buça, një qytet në veri-perëndim të Kievit, që ka parë luftime të ashpra për javë të tëra. Në këtë qytet janë varrosur në një varr masiv rreth 280 civilë.

BE-ja paralajmëron sanksione të reja ndaj Rusisë

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha se Rusia do të përballet "me sanksione të

mëtejme të BE-së" pas raportimeve për krimet e dyshuara të luftës nga forcat ruse në Buça, në periferi të Kievit. Michel shkroi më 3 prill në "Twitter" se ishte i "shokuar nga pamjet e tmerrshme të mizorive të kryera nga ushtria ruse në rajonin e çliruar të Kievit".

Në po të njëjtën ditë organizata Human Rights Watch tha se ka "dokumentuar disa raste ku ushtria ruse ka kryer shkelje të ligjit të luftës kundër civilëve në zonat e okupuara të Çernihivit, Harkivit dhe rajonit të Kievit në Ukrainë".

Kjo organizatë tha se më 4 mars forcat ruse në Buça kishin qëlluar me armë zjarri prapa koke të paktën një

person.

Kryetari i Buçës, Anatoly Fedoruk, tha më 2 prill se afër 300 banorë lokalë janë vrarë në kohën kur ky qytet ishte nën okupimin e forcave ruse. Afër 280 persona dyshohet se janë varrosur në një varrezë masive, ndërkaq trupat e viktimave të tjera janë lënë në rrugët e këtij qyteti.

Pamje të rënda nga ky qytet, ku shihen trupa të banorëve në rrugë, janë shpërndarë në rrjete sociale. "Këto janë pasojat e pushtimit rus", citohet të ketë thënë Fedoruk. Rusia ende nuk është përgjigjur lidhur me këto akuza.

Ndërkaq, më 2 prill, sekretarja e Jashtme britanike, Liz Truss, tha se ishte e tronditur "nga mizoritë në Buça dhe në qytete të tjera në Ukrainë" dhe premtoi se keqbërësit do të ndiqen penalisht.

Në postimin e tij në "Twitter", Michel tha se Bashkimi Evropian po i ndihmon Ukrainës "në mbledhjen e dëshmive të nevojshme, që më pas t'i dërgojë në gjykatat ndërkombëtare".

Gjykata Ndërkombëtare Penale më herët ka hapur një hetim mbi krimet e pretenduara të luftës nga forcat ruse në Ukrainë.

Ndërkaq, në raportin e Human Rights Watch thuhet se janë dokumentuar edhe dhunime, dy raste të ekzekutimeve ku ishin përfshirë shtatë viktimat, dhe raste të tjera të kërcënimeve dhe dhunës ndaj civilëve.



Deri në 20 gardë celsius temperaturat gjatë javës së parë të prillit

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Mbi territorin e Kosovës gjatë javës së parë të muajit prill do të mbizotërojë mot i ndryshueshëm, ka bërë me dije "Prishtina Weather" në njoftimin për medie. Sipas këtij njoftimi, është dita e hënë ajo që do të jetë më e ftohtë, kurse përmirësim i motit pritet menjëherë ditën e mërkurë, duke shkuar temperaturat deri në 20 gradë celsius gjatë ditë së

premtë. "Mot i ndryshueshëm po parashihet për javën e parë të muajit prill. Fillimisht me më shumë vranësira, por pa mundësi të mëdha për të reshura. Në aspektin termik mbetet më ftohtë ditën e hënë, kurse nga e mërkura temperaturat rriten, kur edhe pritet të ketë më shumë diell", thuhet në njoftim. Mot i ndryshueshëm me diell dhe me reshje shiu kohë pas

kohe do të ketë edhe në fundjavë. "Nga dita e enjte sërish parashihet të mbajë mot i vranët, e kohë pas kohe me të reshura shiu, që deri në mbrëmje pushojnë. Ditën e premtë, më ngrohtë e kryesisht me diell. Sipas parashikimeve të fundit, mot të ndryshueshëm do të kemi edhe në fundjavë. Diell e ngrohtë të shtunën, ditën e diel të reshura shiu", ka njoftuar "Prishtina Weather".



Haradinaj kujton të rënët në Kralan: Sakrifica e tyre na obligon t'i ruajmë vlerat e lirisë

GJAKOVË, 3 PRILL (ER) - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar të rënët në Kralan të Gjakovës, shumica të rinj në moshë, e njëmbëdhjetë prej tyre të mitur. "Prilli i vitit 1999 na ndau nga shumë njerëz të dashur e luftëtarë të zotë. Sot kujtojmë të rënët në Kralan, shumica të rinj në moshë, e

njëmbëdhjetë prej tyre të mitur. Kujtojmë bashkëluftëtarin Arton Mehmetaj, i treti dëshmor nga familja Mehmetaj e Glllogjanit, që ra heroikisht përkrah bashkëluftëtarit nga Kukësi, Halit Coka. Kujtojmë bashkëluftëtarët Visar Myftari, Fehmi Shala, Kujtim Qallakaj, Ilir Hoxha, Mustafë Çeku e

dhjetëra dëshmorë anekënd Kosovës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se sakrifica e tyre na obligon t'i çmojmë, kultivojmë dhe ruajmë vlerat e lirisë. "Përgjithmonë në kujtesën tonë historike. Lavdi!", ka shkruar Haradinaj.

Performancë e shkëlqyeshme e kadetëve të FSK-së në akademitë ushtarake amerikane

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka vlerësuar performancën e shkëlqyeshme të kadetëve të FSK-së në akademitë ushtarake amerikane. "Kadeti Alban Bytyqi, student i vitit të parë në Akademinë e Forcave Ajrore Amerikane (USAF), ka realizuar me sukses detyrat

akademike teorike e praktike të semestrit pranveror. Gjatë vizitës akademike në Westpoint, së bashku me kadetin tonë nga Westpoint, Andrin Vuthaj, para gjithë studentëve amerikanë dhe shumë vendeve të tjera, si dhe stafit akademik, prezantuan vendin tonë në mënyrë të

shkëlqyeshme. Krahas krenarisë me djemtë tanë, në lartësinë maksimale mbetet gjithmonë falënderimi dhe mirënjohja e përjetshme për ShBA-në. Alban, Andrin dhe të gjithë ushtarakët tanë kudo që jeni, vazhdojmë me sukseset e radhës!", ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Veliaj: Presidenti i ri i Shqipërisë duhet të jetë në shërbim të publikut



TIRANË, 3 PRILL (ER) - Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, ka folur për profilin që, sipas tij, duhet të ketë presidenti i ri i Republikës së Shqipërisë. Ai ka thënë se Shqipërisë i duhet një president që është në shërbim të publikut, duke marrë shembull ish-presidentin Alfred Moisiu. "Shumë shpejt do të na duhet të mendojmë për presidentin e ardhshëm të Shqipërisë.

Kam dëgjuar debatet që bëhen sot nëpër studiot televizive, edhe brenda partive tona, për ta gjetur identikitin e presidentit të ardhshëm. Njëri thotë duhet të jetë kështu, tjetri thotë duhet të jetë ashtu, të ketë këtë moshë apo atë moshë, por në fund të gjithë kanë një të përbashkët: kush i do të mirën këtij vendi dhe do të sugjerojë identikitin e presidentit të ardhshëm të

Shqipërisë. Ai (presidenti) duhet të jetë si presidenti Moisiu sepse besoj se ka një konsensus të jashtëzakonshëm, përtej bindjeve politike, përtej të majtës dhe së djathtës, përtej myslimanëve dhe të krishterëve, përtej veriut dhe jugut, se ai është identikiti i presidentit që na duhet. Një njeri me rrënjë, një njeri me bosht, që është në shërbim të publikut", ka thënë Veliaj.



NË MJEKIMIN INTENSIV TË SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS (SHSKUK) NUK KA ASNJË PACIENT ME COVID-19

Qetësohet situata me Covid në Kosovë, asnjë pacient në mjekimin intensiv

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të dielën se në Mjekimin Intensiv nuk ka asnjë pacient me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 1 027 testimeve, 19 qytetarë kanë rezultuar pozitiv me virusin Covid-19. Po gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të dielën janë shëruar 33 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 860. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 555

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 PRILL - Asnjë pacient me Covid-19 nuk është duke marrë trajtim mjekësor në kuadër të Mjekimit Intensiv, ka njoftuar të dielën Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK). Në Klinikën Infektive janë katër pacientë të konfirmuar me Covid-19 dhe katër të tjerë me post-Covid-19. Sa iu përket spitaleve të përgjithshme, një pacient është duke marrë trajtim në Spitalin e Gjakovës. Me oksigjeno-terapi janë tre pacientë. Në Klinikën Infektive janë tetë pacientë dhe në Spitalin e Gjakovës është një pacient. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 1 027 testimeve, 19 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të dielën janë shëruar 33 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 860. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 555. Në 24 orët e fundit janë dhënë 49 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 822 698 doza të vaksinës. Deri më sot 820 678 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 224 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19. Më 29 mars është bërë një vit nga fillimi i vaksinimit kundër Covid-19. Ndonëse e ka filluar e fundit në rajon vaksinimin, Kosova ia ka dalë që të ketë

shkallë më të lartë të vaksinimit se shtetet e rajonit, përfshirë Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Bullgarinë dhe shtete të tjera, përderisa ka shkallë të krahasueshme me disa shtete të Evropës. Me mbi 1 820 000 doza të administruara, vaksinimi te popullata mbi 18 vjeçe në Kosovë ka arritur në 70 për qind për qind me një dozë dhe 63.4 për qind me dy doza. Te popullata mbi 12 vjeç janë vaksinuar 62.7 për qind me një dozë dhe 57.1 për qind me dy doza. Sfidë mbetet vaksinimi me dozën e tretë, ku vetëm rreth 7 për qind e popullatës mbi 12 vjeç e kanë marrë atë. Një vit pas, Ministria e Shëndetësisë i ka kalënderuar të gjithë ata që kanë qenë pjesë e procesit të vaksinimit kundër Covid-19 përmes Komitetit për

Imunizim, ekipit menaxhues dhe ekipeve vetëmohuese të vaksinimit në 30 komuna të Kosovës për kontributin që kanë dhënë për shpëtimin e shumë jetëve të njerëzve tonë. Gjithashtu, edhe donatorët që përmes mekanizmave të ndryshëm ndihmuan Kosovën për sigurimin e vaksinave kundër Covid-19 dhe qëndrueshmërinë dhe suksesin e këtij procesi. Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka thënë se vaksinimi mbetet mënyra më e thjeshtë dhe më efektive për parandalimin e formave të rënda të sëmundjes nga Covid-19 dhe u bëri thirrje qytetarëve që të vazhdojnë të vaksinohen, sepse pandemia nuk ka përfunduar ende, ndërsa në vende të ndryshme të botës është duke u përhapur nënvarianti BA 2 i Omicron, që e bën vaksinimin të domosdoshëm. Në vazhdimësi Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë thirrje për kujdes të shtuar ndaj Covid-19. Sipas IKShPK-së, dy variantet e Omicron (BA.1 dhe BA.2) po vazhdojnë të përhapen me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve dhe me raste fatale. "Virusi është

kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet e panevojshme, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja. IKShPK-ja, gjithashtu, ka njoftuar se është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen. "Është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19 dhe parandalimin e valës së re. Omicron është tejet ngjites, andaj mbani maskat në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po qe se të gjithë bartin maska", ka njoftuar IKShPK-ja.

Osmani: Disa zyrtarë dyshohen për veprimtari spiunimi në Bullgari

SHKUP, 3 PRILL - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha të dielën se janë zbuluar disa persona të institucioneve maqedonase që, sipas tij, kanë kryer veprimtari spiunimi tek autoritetet bullgare, duke i demotivuar që të mos punojnë për zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë.

Deklarata e Osmanit vjen një ditë pas asaj të kryeministrit bullgar Kiril Petkov, i cili, gjithashtu, tha se edhe në Bullgari ka persona të dyshuar me orientime pro ruse që punojnë për prishjen e raporteve me Maqedoninë e Veriut.

Shefi i diplomacisë maqedonase, Bujar Osmani, tha se personat e dyshuar për propagandë kundër zgjidhjes së kontestit e kanë ndërlikuar gjoja me mungesën e stabilitetit politik dhe

zgjedhjet e mundshme parlamentare. “Sa më shumë që po rriten mundësitë për gjetjen e një zgjidhjeje për ta përshpejtuar rrugën evropiane, aq më tepër do të ketë njerëz të shqetësuar që kanë punuar gjatë gjithë kësaj kohe për të penguar që kjo perspektivë të ndodhë. Këtu do të marr një shembull konkret, këtë javë disa njerëz nga Maqedonia e Veriut kanë telefonuar Bullgarinë duke thënë se i gjithë angazhimi është i panevojshëm sepse këtu do të ketë zgjedhje të shpejta, se do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe se nuk mund të arrihet zgjidhje”, tha Osmani. Sipas tij, “përpjekje të tilla janë nga njerëz në institucione që janë në linjë me komentet e kryeministrit bullgar Petkov, se ka njerëz që do të përpiqen ta mbajnë të hapur çështjen me Bullgarinë, ta mbajnë të bllokuar procesin



e integritetit evropian, në mënyrë që ky rajon të jetë gjithmonë një zonë që dikush ta përdorë atë për të arritur qëllimet e veta”.

Megjithatë, Osmani nuk ka dhënë hollësi se kush janë këtë njerëz që kanë “spiunuar” në Sofje apo se çfarë postesh mbajnë në institucionet e Maqedonisë së Veriut. Osmani tha se “rajoni, shtetet anëtare

të BE-së, BE-ja, Aleanca transatlantike, kanë nevojë për leadership strategjik në këtë periudhë në mënyrë që rajoni të konsolidojë sigurinë, politikisht dhe ekonomikisht”. Kryeministri bullgar Kiril Petkov tha të shtunën se spiunët e dyshuar rusë në institucionet bullgare po punojnë për t’i prishur marrëdhëniet në mes të Sofjes

dhe Shkupit.

Për veprimtari spiunimi Sofja dyshon te tre bullgarë, dy prej të cilëve tyre punonin në Agjencinë Shtetërore të Sigurisë Kombëtare dhe i treti në një ministri.

Autoritetet bullgare nuk bëjnë me dije as identitetin e as veprimtarinë e tyre të “spiunimit”.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut dhe ai i Bullgarisë, Dimitar Kovačevski dhe Kiril Petkov, më 28 mars thanë se nuk përjashtohet mundësia që dy vendet së shpejti ta zgjidhin kontestin për gjuhën dhe identitetin maqedonas si dhe të kaluarën historike mes dy vendeve.

Një marrëveshje e mundshme do të çonte në heqjen e vetos bullgare të vendosur në nëntor të vitit 2020 me çka Maqedonia e Veriut do të niste bisedimet e anëtarësimit me BE-në.

Serbët nga Kosova votojnë në Serbi



PRISHTINË, 3 PRILL - Qytetarët serbë nga Kosova kanë shkuar të dielën në Serbi për të votuar për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare serbe, të cilat u mbajtën më 3 prill, pasi që Qeveria e Kosovës për herë të parë nuk lejoi mbajtjen e zgjedhjeve serbe brenda territorit të Kosovës.

Më shumë se 25 autobusë u panë në stacionin e autobusëve në Mitrovicë të

Veriut për t’i transportuar serbët për të votuar në Rashkë.

Rashka është një nga komunat në Serbi pranë kufirit me Kosovën.

Transporti u është mundësuar edhe serbëve në Graçanicë. Në orët e para të mëngjesit të së dielës, serbët, kryesisht punonjësit të institucioneve serbe në Kosovë, u dërguan me autobus në vendvotimet e tyre në qytetin kufitar të

Serbisë, Kurshumli. Transporti i qytetarëve për në Serbi është bërë nën organizimin e komunave serbe, si ato që funksionojnë në sistemin e Kosovës, po ashtu ato në sistemin e Serbisë. Komisioni Republikan i Zgjedhjeve të Serbisë ka thënë se rreth 100 000 serbë nga Kosova do të mund të votojnë në vendvotimet e tjera që gjenden në komunat në kufi me Kosovën siç janë Tutini,

Rashka dhe Vranja. Policia e Kosovës ka njoftuar se për shkak të qarkullimit të shtuar të qytetarëve serbë të cilët po shkonin në Serbi për të votuar, kanë krijuar kolona dhe pritje në dy pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak, që lidhin Kosovën me Serbinë. Ndërkaq, sa i përket aspektit të sigurisë lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë, Policia e Kosovës tha se situata ishte e qetë dhe stabile. “Policia e

Kosovës në këtë fushëveprim ka paraparë masat dhe veprimet e Policisë së Kosovës në funksion të ruajtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, garantimit të sigurisë së përgjithshme, si dhe shtimit të kapaciteteve të personelit policor në pikat kufitare me qëllim të mundësimit të lëvizjes së lirë dhe qarkullimit kufitar”, u tha në njoftimin e policisë.

Po luanin bixhoz, policia arreston 13 persona në një lokal në Prizren

PRIZREN, 3 PRILL (ER) - Policia në Prizren kishte pranuar një informatë se në rrugën "Njazi Alishani" në Prizren në një lokal është duke u luajtur bixhoz. Policia ka njoftuar se brenda lokalit me mbishkrimin "OBESSS" ka hasur personat të cilët kanë qenë duke luajtur bixhoz me letra në një tavolinë.

Pronari ka deklaruar se disa persona kanë luajtur bixhoz, ku atij i kanë paguar nga 1 euro për një orë lojë. Në lidhje me veprimet policore është kontaktuar prokurori i shtetit i cili ka udhëzuar që të sekuestrohen sendet e gjetura në cilësinë e provave materiale. Pas intervistimit të personave të dyshuar, e

konsultimit me prokurorin e shtetit, është iniciuar rasti "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm" ndaj 13 personave, pronari i lokalit S. G është ndalua për 48 orë me vendim të prokurorit, ndërsa 12 të tjerë të dyshuar janë liruar në procedurë të rregullt. Rasti është duke u hetuar.



Në cilat organizata ndërkombëtare do të aplikojë Kosova për anëtarësim?

PRISHTINË, 3 PRILL - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, ka bërë me dije se kanë bërë listën e prioritetëve për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Ai ka thënë se Kosova do të aplikojë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Këshillin të Evropës dhe do të shohin mundësitë për përafrim me NATO-n, fillimisht duke u anëtarësuar me të drejta të plota në kartën e Adriatikut A5. Mirëpo të gjitha këto Ahmeti ka theksuar se do të bëhen në momentin e duhur dhe të vulltshëm për vendin. Ahmeti ka thënë se kanë hartuar strategjinë për njohje të reja dhe janë në kontakt me një numër të konsiderueshëm të shteteve që nuk e njohin Kosovën. Në këtë drejtim ai ka thënë se janë duke punuar intensivisht për t'u

kundërvënë Serbisë në fushatën për tërheqje të njohjeve për Kosovën. "Kemi bërë listë të prioritetëve se ku Kosova ka interes të veçantë për t'u anëtarësuar. Tashmë dihet se Kosova do të aplikojë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ne kemi propozuar dhe është themeluar një grup ndërinstytucional për përafrim me NATO-në, por kjo nuk është vetëm për NATO-n, por edhe mekanizmat e tjerë rajonalë dhe ndërkombëtarë të sigurisë. Ne duhet të kemi të qartë se rruga drejt anëtarësimit edhe në NATO nuk bëhet brenda natën, por duhet të punojmë çdo ditë. Një hap konkret do të ishte që Kosova të anëtarësohet në kartën e Adriatikut A5 që ne tashmë i plotësojmë të gjitha kushtet. Ne kemi qenë duke punuar për Këshillin e Evropës, kjo punë



është dinamizuar, se kur do të aplikojmë nuk është vendosur, por se do të aplikojmë kjo është e qartë. Është shumë e rëndësishme që, përveç përgatitjes së brendshme, ta

gjejmë edhe çastin e duhur. Nuk është aq e rëndësishme shpejtësia drejt fillimit të procesit sa është e rëndësishme që kur të fillojë procesi të jemi të sigurt se do të jetë i suksesshëm.

Problemi është se e kemi parë edhe me UNESCO-n që në rast se dështon, nuk është se mbetesh në vendnumërim, por ki ngecje", ka thënë ai për "Kosovapress".



KOSTT-i pranë kolapsit financiar, s'ka para për ta paguar rrymën në veri

PRISHTINË, 3 PRILL - Kompania Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT) është para kolapsit financiar për shkak të kostonë së lartë për pagesën e rrymës në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. KOSTT-i vetëm në dy muajt e parë të këtij viti, për janar dhe shkurt, ka paguar rreth 13

milione euro për rrymën e shpenzuar nga qytetarët serbë në katër komunat e veriut të Kosovës. Derisa sa i përket muajit mars, kostoja financiare pritet të jetë dukshëm më e lartë se në muajt paraprakë. Kostoja totale financiare për pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021 ishte rreth

41 milionë euro. Zëdhënësjja e kësaj kompanie, Zana Bajrami-Rama, ka thënë për "Kosovapress" se si pasojë e situatës së pazgjidhur në pjesën veriore të Kosovës, si dhe obligimeve të pashlyera të palëve, gjendja financiare e KOSTT-it është jashtëzakonisht e rënduar.

PDK-ja vazhdon organizimin në Zvicër, themelon nëndegë në kantonin Schwyz

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Partia Demokratike e Kosovës po vazhdon organizimin e aktiviteteve në Zvicër, kudo ku jeton mërgata shqiptare. Udhëheqësi i Departamentit të Diasporës në PDK, deputeti Elmi Reçica, ka ndjekur nga afër mbajtjen e kuvendit zgjedhor të

nëndegës së Partisë Demokratike të Kosovës për Kantonin e Schwyz, ku kryetar i kësaj nëndege është zgjedhur Esat Saqipi, si dhe kryesia e nëndegës dhe delegatët për kuvendin e degës. "Në këtë takim të pranishëm ishin veprimtarë, intelektualë dhe aktivistë të

devotshëm të PDK-së, të cilët në formë të ndryshme kanë kontribuar e mbështetur Kosovën dhe Partinë Demokratike të Kosovës. Së bashku ne do të punojmë që në vazhdimësi ta shtrijmë dhe fuqizojmë PDK-në në diasporë", ka thënë Reçica.



Reforma sociale, peng i 47 milionë eurove



PRISHTINË, 3 PRILL - Projekti i reformimit të sistemit të ndihmës sociale në Kosovë - ndonëse i publikuar tash e sa muaj - duket se ka mbetur peng i miratimit të një kredie ndërkombëtare në vlerë prej 47 milionë eurosh. Kjo kredi është nënshkruar në tetor të vitit të kaluar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA), që është pjesë e Bankës Botërore.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere në Kuvendit të Kosovës e ka miratuar në parim projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, por kur ka dalë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës në janar ai nuk ka kaluar edhe është kthyer sërish në qeveri.

Në një seancë të Kuvendit, të mbajtur javën e kaluar, Armend Muja, deputet i partisë në pushtet - Lëvizjes Vetëvendosje, ka bërë thirrje që marrëveshja për kredinë të procedohet dhe të miratohet sa më shpejt në Kuvend. "Është e rëndësishme. Ato janë para për t'i ndihmuar shtresat më të varfra të Kosovës. Nëse pretendohet se ka inflacion, është koha për t'i ndihmuar këto shtresa", ka thënë Muja.

Disa deputetë të opozitës e kundërshtojnë marrëveshjen, e cila, meqë është ndërkombëtare, duhet patjetër të ratifikohet në Kuvend. "Kurrë, asnjëherë, Kosova nuk ka marrë kredi për të paguar paga apo asistencë sociale. Është kundër logjikës fiskale", ka thënë Avdullah Hoti

nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në të njëjtën seancë të Kuvendit.

Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve e Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se kur do të dërgohet në Kuvend marrëveshja për kredinë me Bankën Botërore. REL-i e ka pyetur këtë ministri edhe ku ka arritur me projektin e reformës sociale, por nuk ka marrë përgjigje.

Qysh në gusht të vitit të kaluar Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve ka publikuar në uebfaqe një projekt për reformën sociale, që thuhet se ka për qëllim ta zbusë varfërinë. Me të, siç thuhet në dokument, synohet "të përmirësohet sistemi i ofrimit të mbrojtjes sociale", si dhe "të promovohet aktivizimi i përfituesve të ndihmës sociale në tregun e punës".

Dokumenti, megjithatë, nuk jep hollësi se si mund të realizohen këto dhe çështje të tjera që përmenden aty. Sipas deklarimeve të mëhershme të ministrit të Punës, Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, projekti i reformës sociale do të mundësohet me kredinë prej 47 milionë eurosh nga Banka Botërore dhe do ta zgjerojë bazën e asistencës sociale në raport edhe me nevojat e qytetarëve.

Murati, po ashtu, ka thënë se ky projekt do të krijojë mekanizma që i ndihmojnë familjet në nevojë të dalin nga varfëria, duke u siguruar atyre ndërlidhje me tregun e punës.

Më shumë se 25 mijë familje me asistencë sociale

Në Kosovë, sipas të dhënave të muajit shkurt të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, më shumë se 25 000 familje me 102 333 anëtarë kanë marrë asistencë sociale nga buxheti i shtetit të Kosovës. Shuma e rregullt që marrin këto familje është nga 60 deri në 180 euro në muaj, varësisht nga numri i anëtarëve. Familja Çitaku nga Mitrovica e Jugut është një prej atyre që marrin nga 110 euro në muaj.

Kryefamiljari Mexhiti, i cili jeton bashkë me gruan, vajzën dhe djalin, thotë se merr asistencë sociale qysh nga viti 2004. Por, sipas tij, shumica është e mjaftueshme vetëm për ilaçe. "Përpara, kur kanë qenë gjërat më lirë, ia dilja disi. Tash janë shtrenjtuar shumë, nuk kam mundësi t'ia dal. Bashkëshorten dhe djalin i kam të sëmurë. Tash edhe unë kam fituar bronkit. I kam bërë disa kontrole te mjeku. Terapia më bëhet 200 euro. Nuk kam se si t'i siguroj paratë dhe nuk po mjekohem fare", thotë Çitaku për "Radion Evropa e Lirë".

Me ushqime ai thotë se ndihmohet nga fqinjët dhe bashkëqytetarë të tjerë. Ai shprehet se me shumë dëshirë do të punonte por, siç shprehet, e ka të pamundur, pasi i duhet të kujdeset për bashkëshorten dhe djalin. Djali i tij, 15 vjeç, ndjek mësimet në shkollë të mesme,

ndërsa vajza e ka përfunduar shkollimin e mesëm, por nuk ka gjetur punë. Asistenca sociale në Kosovë u jepet familjeve me kushte të vështira financiare dhe që nuk kanë asnjë anëtar të punësuar.

Miliona euro për skema sociale

Ndonëse të pamjaftueshme për disa, këto asistencë buxhetit të Kosovës i kushtojnë miliona euro në vit. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shumica e mjeteve që janë ndarë për familjet në nevojë në muajin shkurt ka qenë mbi 3 milionë euro. Sipas një analize të Bankës Botërore, të publikuar në mars, Kosovës i duhet t'i reformojë programet e saj për mbrojtje sociale në atë mënyrë që ta shkurtojë varfërinë në vend.

Kosova, në total, ka 15 skema sociale e pensionale, nga të cilat përfitojnë mbi 400 mijë qytetarë. Për mbulimin e tyre nga buxheti i shtetit ndahen mbi 500 milionë euro çdo vit. Buxheti i Kosovës për vitin 2022 është 2.7 miliardë euro.

Përveç qytetarëve të papunë dhe me vështirësi sociale, nga skemat sociale përfitojnë edhe familjarë të dëshmorëve, veteranë të luftës, pensionistë të moshës etj. Shumat mujore që ndahen për ta janë të ndryshme dhe, sipas Bankës Botërore, ato "krijojnë pabarazi". "Shpenzimet për ndihmë sociale në Kosovë janë të

orientuara drejt transfereve të parave të gatshme që nuk kanë lidhje me varfërinë, duke e bërë sistemin për mbrojtje sociale të pabalancuar, përkundër buxhetit të konsiderueshëm", thuhet në analizën e Bankës Botërore. Sipas saj, "është koha" që Qeveria e Kosovës "ta reformojë sistemin për mbrojtje sociale dhe ta përdorë atë për ta zhdukur varfërinë, për të rritur punësimin, si dhe për të ofruar kushte të mira jetese për të gjithë".

Skemat sociale të Kosovës janë kritikuar shpesh edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili ka tërhequr vërejtjen se ato mund ta fusin Kosovën në krizë fiskale. Edhe njohës të çështjeve ekonomike dhe sociale kanë kërkuar vazhdimisht që Kosova t'i modifikojë skemat sociale.

Punësimi i disa personave që marrin ndihmë sociale do të ishte mënyra më e mirë e zbutjes së varfërisë ka thënë në një deklaratë të mëhershme për "Radion Evropa e Lirë", Behxhet Gaxhiqi, profesor i Shkencave Sociale në Universitetin e Prishtinës.

Të dhënat e fundit të Bankës Botërore për varfërinë në Kosovë janë të vitit 2017 dhe, sipas tyre, mbi 23 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri.

Në Kosovë pothuajse të gjitha produktet e konsumit janë shtrenjtuar dukshëm që nga viti i kaluar. Në shkurt inflacioni ka arritur në 7.5 për qind, krahasuar me 0.7 për qind sa ka qenë në të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në luftën e Putinit kundër Ukrainës, Perëndimi po i fiton betejat ekonomike



Nga Sebastian MALLABY
"The Washington Post"

Ndërsa po vazhdon lufta në Ukrainë, Perëndimi vazhdon që të domonojë në fushëbetejën ekonomike. Sanksionet e tij po ndëshkojnë rëndë ekonominë ruse. Përpykjet e ushtrisë për një kundërsulm duket se kanë gjasa të dështojnë. Dhe rezultati është një goditje psikologjike për Kinën, sistemi shtetëror-kapitalist i së cilës dukej tashmë i brishtë.

Së pari marrim sanksionet. Duke ngrirë pjesën më të madhe të rezervave valutore të Rusisë, Perëndimi e çaktivizoi mjetin kryesor të Moskës për mbrojtjen e monedhës së saj. Në 2 javët e para të luftës, rubla e humbi gati gjysmën e vlerës së saj kundërsht dollarit.

Rritja e çmimeve të importit, blerjet në panik e sipër nga qytetarët rusët, dhe mungesat e shkaktuara nga sanksionet e tjera, e rritën inflacionin deri në 2 për qind në javë. Nëse do të ruhet kjo normë, inflacioni vjetor i Rusisë do të arrijë në nivelin katastrofik prej 175 për qind.

Udhëheqësit e Rusisë janë përpjekur që ta mbështesin rublën, por kjo gjë ka sjellë vështirësi të reja. Banka Qendrore e ka dyfishuar normën bazë të interesit, duke ndëshkuar bizneset dhe familjet, duke i nxitur kështu ekspertët të

parashikojnë një recesion ekonomik të thellë.

Autoritetet kanë goditur fort kontrollin e kapitalit, duke i penguar rusët e zakonshëm që të shkëmbejnë rublat me dollarë, dhe duke u kufizuar aftësinë për të nxjerrë dollarë nga llogaritë e tyre bankare. Rusët me më shumë mundësi po largohen nga vendi.

Rreth 70.000 punonjës të teknologjisë thuhet se janë larguar tashmë. Sanksionet kanë goditur edhe investitorët e huaj. Rusia i ka ndaluar jo-rezidentët që të shesin aksionet që kanë në Moskë. Sanksionet kanë penguar ndërkohë edhe pagesat e interesit për zotëruesit e huaj të obligacioneve.

Të tmerruar nga shkatërrimi i qyteteve në Ukrainë, rreth 500 biznese perëndimore që operonin në Rusi janë tërhequr tashmë, madje shumë prej tyre pa një plan të qartë se si mund t'i shesin asetet që kanë në këtë vend dhe se si do mund të rikuperojnë kapitalin.

Gjiganti britanik i naftës "British Petroleum" pritet të pësojë një dëm prej 11 miliardë dollarësh nga largimi i saj nga Rusia. Besimi i biznesit të huaj nuk ka gjasa të rikuperohet për sa kohë që në Kremlin të jetë Vladimir Putin. Lëvizja e fundit e Rusisë ishte kushti që eksportet e saj të gazit natyror të paguhen në rubla. Ideja e Moskës është të detyrojë Gjermaninë dhe importuesit e tjerë të

energjisë që të blejnë gaz dhe naftë në monedhën ruse, duke e rritur kështu vlerën e saj. Por qeveria gjermane duket e gatshme që të mos e pranojë bllofin e Putinit.

Në vend se të pranojë të paguajë në rubla, ajo ka ndërmarrë hapin e parë zyrtar drejt racionimit të gazit. Në vend se ta privojë veten nga të ardhurat që i duhen dëshpërimisht, Rusia mund të tërhiqet nga kjo lëvizje. Sido që të shkojnë gjërat, kërcënimi i Rusisë e ka përforcuar më tej vendosmërinë e Gjermanisë për t'u larguar nga eksportet ruse.

Dhe çfarë do të thotë e gjitha kjo për Kinën, aleatën më të rëndësishme të Putinit? Ekonomia kineze është shumë më e madhe dhe më e sofistikuar se ajo e Rusisë. Por duket sërish e cënueshme. Së pari, stoku i aseteve në valutë të huaj i Pekinit prej 3 trilion dollarësh, duket më pak i fuqishëm se dikur.

Nëse ka qenë e mundur ngrirja e rezervave valutore të Rusisë, e njëjta gjë mund të ndodhë edhe me ato të Kinës. Po kështu, nëse Rusia nuk mund t'i përdorë dot si mjet presioni eksportet e saj energjetike, ngjan e pamundur që Kina të jetë në gjendje t'i kundërvihet sanksioneve, duke kërcënuar se do të reduktojë eksportet e produkteve elektronikë.

Është e vërtetë që Kina furnizon rreth 80 për qind të

tregut amerikan për inputet industriale të njohura si "minerale të rralla". Por Shtetet e Bashkuara po mbrojnë veten duke i grumbulluar dhe ricikluar ato. Për më tepër, ekonomia e Kinës duket shumë e ndjeshme për arsye të tjera. Ashtu si Putin pushtoi Ukrainën i shtyrë nga një ndjenjë e gabuar e krenarisë kombëtare, edhe udhëheqësit e Kinës kanë refuzuar të blejnë vaksinat e huaja shumë më efektive kundër Covid-19. Edhe pse vaksinat vendase nuk funksionojnë, ata e kanë izoluar vendin e tyre nga pjesa tjetër e botës, duke vendosur karantina drakoniane për vizitorët.

Por me shfaqjen e variantit veçanërisht infektiv BA.2 omicron, nuk mjafton as kjo. Kina është detyruar të mbyllë qendrat ekonomike si Shenzhen dhe Shanghai, duke penguar perspektivën e saj të rritjes ekonomike. Ndërkohë, me luhatje paraqitet edhe sektori financiar i Kinës. Zhvilluesit e pronave të paluajtshme po falimentojnë, dhe po braktisen nga investitorët e tjerë. Gati 2/5 e kredive bankare janë të lidhura me pronat e paluajtshme, ndaj kjo krizë pritet të infektojë gjithë sistemin bankar.

Ekonomia e Kinës është e varur nga borxhet, ndaj nëse bankat do të kërkojnë kreditë e tyre, kriza do të jetë shumë e fortë. Qeveria e Kinës i ka ndërlikuar problemet e saj duke e goditur ekonominë e

saj dixhitale mbresëlënëse. Ajo i ka gjobitur kompanitë kryesor të teknologjisë, ka bllokuar angazhimin e tyre në bursa, dhe i ka shtyrë të mërgojnë jashtë vendit themeluesit e tyre.

Verën e vitit që shkoi, me një të rënë të lapsit, ajo zhduku pjesën më të madhe të industrisë fitimprurëse të mësimdhënies prej 100 miliardë dollarësh. Duke pasur parasysh se popullsia e Kinës po plakët dhe fuqia e saj punëtore po zvogëlohet, qeveria ka nevojë për plotësimin e produktivitetit nga kompanitë e teknologjisë. Është kjo arsyeja pse zyrtari më i lartë ekonomik i Pekinit, është sjellë mirë kohët e fundit me këtë sektor. Por jo të gjithë presin që gjërat të përmirësohen. Qeveritë autoritare e kanë të vështirë të tolerojnë inovacionet përçarëse. Perëndimi ka përjetuar disa vite rraskapitëse.

Populistët e kanë rritur shumë ndikimin e tyre, janë shkatërruar aleancat tradicionale, dhe çdo gjë nga inflacioni deri tek tërheqja kaotike e SHBA-së nga Afganistanit, dukej se sinjalizonte paaftësinë dhe brishtësinë. Por kriza e Ukrainës e ka ndryshuar situatën. Sigurisht, konflikti është larg përfundimit. Por tani për tani, Perëndimi ka një vetëbesim të madh të panjohur më parë.

Shënim: Sebastian Mallaby, bashkëpunëtor në Institutin Paul A. Volcker për ekonominë ndërkombëtare.

Si lind një diktator? Ja çfarë na mëson historia

Nga Jordan FEARN
"History of Yesterday"

Përgjatë gjithë historisë, janë ngritur dhe rrëzuar shumë diktatorë. Në të gjitha kulturat, fetë dhe kontinentet ne shohim burra që përpiqen ta centralizojnë pushtetin në duart e tyre, dhe të sundojnë mbi fisin, qytetin apo perandorinë e tyre.

Nga bëmat e hershme të tiranëve shekujve VII-VI Para Erë Sonë, Kipselusit dhe Kleistenit në Greqinë e Lashtë, deri tek historitë legjendare të Kornel Sulës, Jul Çezarit dhe Augustit në Romën e Lashtë gjatë shekujve II dhe I Para Erës Sonë.

Më pas kalojmë në shekullin XII-të të Erës Sonë me udhëheqësin mongol Xhengiz Khan, tek diktatorët si Simon Bolívar, Antonio Blanco dhe Rafael Karrera, të gjithë diktatorë të famshëm të Amerikës së Jugut që sunduan në shekujt XVIII-XIX.

Në kohët më moderne kemi pasur diktatorë si Josip Tito, që drejtoi Jugosllavinë gjatë viteve 1944-1980; Idi Amin, që sundoi brutalisht mbi Ugandën në vitet 1971-1979; Li Kuan Ju, udhëheqës i Partisë së Veprimit Popullor në Singapor në vitet 1959-1990, edhe pse shpesh vlerësohet si një sundimtar dashamirës.

Pastaj vijmë tek diktatorët më të famshëm: Muamar Gadafi, që sundoi Libinë në vitet 1969-2011, formalisht nominalisht nën maskën e një socialisti revolucionar. Diktatorë si Musolini, Hitleri dhe Stalini, nuk kanë shumë nevojë për prezantim.

Duke sunduar përkatësisht Italinë, Gjermaninë dhe Bashkimin Sovjetik, këta tre diktatorë të Luftës së Dytë Botërore e mishëruan këtë fjalë në imagjinatën moderne, dhe dëshmojnë në mënyrë të qartë se nuk ka dy diktatorë të njëjtë, dhe se secili ngjitet në pushtet në mënyrën e vet.

Në kohën tonë kemi diktatorë si presidenti kinez Xi Jinping në Kinë, Llukashenko në Bjellorusi dhe Vladimir Putin në Rusi. Augusti ishte i famshëm për sundimin e Romës, me pretekstin se ishte thjesht senatori i radhës, si i pari mes të barabartëve.

Në realitet ai tërhoqte nga pas fijet e qeverisjes, dhe e uzurpoi senatin romak për të imponuar vullnetin e tij përmes marrëveshjeve dhe kërcënimeve që bënte në prapaskenë, duke themeluar përfundimisht një sistem që e bëri atë një monark në të gjitha aspektet, përveç titullit zyrtar.



Udhëheqësi turk Erdogan është ndoshta shembulli më i mirë për këtë. Thënë thjesht, ne nuk e dimë se sa pushtet ka ai. Edhe pse nuk ka gjasa ta kontrollojë vendin në atë masë sa Partia Komuniste në Kinë dhe sa Putin në Rusi, do të ishte një injorim i fakteve, të sugjerohej se Turqia është sot një demokraci funksionale siç e imagjinojmë ne në Perëndim.

Kështu po e përkufizoj edhe diktatorin: një njeri ose ndoshta një organ më të gjerë (si për shembull Partia Komuniste Kineze), që e centralizon pushtetin tek vetja. Po si lindin diktatorët? Ata sigurisht nuk dalin nga hiçi. Marrja nën kontroll e proceseve demokratike të një shteti (kjo është mënyra se si ngrihen shumica e diktatorëve), kërkon shpesh ose një ndryshim të fuqishëm të papritur ose vite ndryshimesh dhe kryengritjesh të zgjatura.

Pas Luftës së Parë Botërore, shteti gjerman u ndëshkua me detyrimin për të paguar dëmshpërblime të mëdha për luftën. Aq të mëdha ishin ato detyrime, sa që shlyerja e tyre përfundoi vetëm në vitin 2010. Kjo shkaktoi hiper-inflacion dhe në një kolaps të plotë të ekonomisë gjermane.

Shumë familje jetonin rrugëve, punë nuk kishte, plaçkitjet dhe krimi kapën majat, ndërsa ushtarët e zhgënjyer nga realiteti i ashpër i Luftës së Madhe mezi po mbijetonin. Republika e Vajmarit ishte e

dobët dhe e paaftë për të mbështetur njerëzit mbi të cilët sundonte.

Më e rëndësishmja, u thye shpirti i popullit gjerman. Duke shfrytëzuar rastin Hitleri i bëri jehonë historisë së një komploti global, asaj të një aleance midis hebrenjve dhe komunistëve, që synonte të zhdukte popullit arian, i cili ishte i destinuar të sundonte botën.

Republika e dështuar e Vajmarit, nuk ishte në gjendje të frenonte rritjen meteorike të popullaritetit të Hitlerit. Me betimin e tij si Kancelar dhe me zjarrin që dogji parlamentin, Reichstag (me shumë mundësi i vënë nga vetë nazistët) në fillimin e vitit 1933, Hitleri pati fuqinë dhe pretekstin për të filluar çmontimin e vazhdueshëm të Republikës së Vajmarit dhe krijimin e Rajhut të Tretë.

Në mënyrë të ngjashme, Augusti u ngjitet në pushtet në mesin e 2 luftërave civile. E para ishte lufta e babait të tij adoptiv Jul Çezarit, dhe e dyta ishte lufta e tij civile kundër Mark Antonit, që do të përfundonte me fitoren e Augustit. Kontrolli i tij mbi shtetin, u mirëprit si nga njerëzit ashtu edhe nga elitat e fuqishme në senat, pasi mbretërimi i Augustit solli paqe në një perandori që kishte qenë në luftë me vetveten më shpesh sesa jo në 60 vitet e mëparshme.

Josif Stalin u ngjitet në pushtet gjatë revolucionit komunist në Rusi. Pas vdekjes së Vladimir Leninit në vitin 1924, Stalini e

përdori postin e tij si Sekretar i Përgjithshëm për të vendosur besnikët e tij në çdo pozicion kyç, duke spastruar të gjitha fraksionet e kundërshtarëve, sidomos ato të drejtuara nga armiku i tij brenda partisë bolshevik, Leon Trocki.

Stalini do të përdorte kontaktet e tij brenda policisë sekrete për të monitoruar kundërshtarët e tij, dhe do t'i detyronte ata të mërgonin jashtë vendit, teksa po ndërtonte kultin e tij të personalitetit. Ai moment do të ishte preludi i një numri shumë të madh njerëzish që do të humbnin jetën nga terrori stalinian.

Idi Amin nuk ishte lloji i njeriut që do doje ta takojë në rrugë, apo diku tjetër. I mbiquajtur "Babai i madh", ishte 1.93 metra i gjatë. Për 9 vite kishte qenë kampioni boksit i peshave të rënda në Ugandë. Në vitin 1946 u bë pjesë e gardës mbretërore.

Kur Uganda shpalli pavarësinë nga Britania në tetor 1962, Amin iu bashkua ushtrisë së Ugandës, duke u bërë komandanti i të gjitha forcave të armatosura. Në vitin 1971 kreu njëgrusht shteti kundër presidentit Milton Obote. Vendosi ligjin ushtarak, dhe më pas njëdiktaturë të egër.

Gjatë regjimit të tij besohet se janë vrarë 100.000-500.000 njerëz, vetëm brenda 8 viteve. Ishte sërish një grusht shteti nga vetë ushtria e tij, ajo që e detyroi Amin të arratisë në Arabinë Saudite, ku edhe vdiq në vitin 2003, në moshën 78

vjeçare.

Në Korenë e Veriut, i gjithë informacioni që qarkullon monitorohet me kujdes nga Departamenti i Publicitetit dhe Agjitacionit. Dinastia Kim po qeveris prej 77 vitesh, duke detyruar njerëzit të mësojnë idetë e Juche, ideologjinë e Kim-Il-Sung, e cila bazohet në pavarësinë ekonomike dhe mbështetjen e plotë të shtetit komunist tek vetja.

Kontrolli i mendimeve të njerëzve, është thelbësor për një diktator. Por kur kontrolli i informacionit shkon keq, kjo mund të jetë fatale për qeverinë diktatoriale. Dhe kjo na çon tek historia aktuale e pushtimit rus të Ukrainës. Sot shumë ekspertë ushtarakë, po shkruajnë në rrjetet sociale se pushtimi rus po ecën shumë keq.

Duke qenë subjekt i propagandës së presidentit Putin, do të ishte e arsyeshme të supozohej se populli rus i besonte ato që ai i tha për luftën. Por Putin bëri një gabim. Duke pasur akses në botën e jashtme, shumë rusë janë në gjendje të verifikojnë gënjeshttrat që u janë thënë.

Nëse është me fat, Putini do të përfundojë si Idi Amin, duke jetuar pjesën tjetër të jetës në luks. Nëse është i pafat, ai do të pësojë një fat të ngjashëm me Musolinin. Sido që të jetë, ka shumë pak gjasa që ai të jetë diktatori i fundit që do të ngrihet dhe do të bjerë.

Marrë me shkurtime nga
History of Yesterday – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ndërprerët derbi Gjilani-Ballkani, Stivi Frashëri bëhet për spital



Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës do të merr vendim për ndeshjen që u ndere pak para përfundimit mes Gjilanit dhe Ballkanit. Portieri i skuadrës mysafire Stivi Frashëri është sulmuar nga huliganet që hynë në fushë pas barazimit të rezultatit

EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 PRILL - Ndeshja kryesore e javës së 27-të mes Gjilanit dhe Ballkanit është ndërprerë pak minuta para përfundimit. Në fakt, Ballkani shënoi e para në minutën e parë të ndeshjes me anë të Krasniqit, por vendasit e barazuan rezultatit në minutat shtesë më golin e portierit Koliçi. Tifozët vendas pas barazimit të rezultatit hynë në fushë dhe në tollovinë e krijuar portieri i mysafirëve Stivi Frashëri është sulmuar, fillimisht është kapur për fyti e me pas është shqelmuar. Portieri i Ballkanit është dërguar me ambulancë në spital, derisa gjendja e tij

është stabile. Sulmin ndaj Frashërit e kanë dënuar të gjithë, përfshi edhe Ministrinë e Sportit. MKRS-ja ka falënderuar Policinë e Kosovës për reagimin e tyre në arrestimin e të dyshuarve. Ministria gjithashtu njoftoi se për të hënë ka ftuar mbledhje të Këshillit Kombëtar për Parandalimin e Dhunës në Sport për t'i shqyrtuar veprimet e radhës. "Ministria e Sportit dënon ashpër dhunën e ushtruar ndaj portierit të Ballkanit, Stivi Frashëri dhe gjithë situatën e krijuar në ndeshjen e futbollit Gjilani - Ballkani. Këto pamje nuk përkohjnë me frymën sportive dhe të gjithë përgjegjësit do të marrin përgjigjen e merituar. E falënderojmë

Policinë e Kosovës për reagimin e tyre të shpejtë në arrestimin e të dyshuarve. Për ditën e nesërme kemi ftuar mbledhje të Këshillit Kombëtar për Parandalimin e Dhunës në Sport për t'i shqyrtuar veprimet e radhës. Jemi të përkushtuar të bëjmë gjithçka mundemi për t'i mbajtur huliganët jashtë fushave të sportit. Portierit Stivi Frashëri i urojmë shërim të shpejtë dhe të plotë", thuhet në postimin e MKRS-së.

Fitojnë Drenica, Prishtina dhe Drita

Drenica mposhti Feronikelin me rezultat 6-0. Pjesa e parë e ndeshjes u karakterizua me dominim të vendasve, të cilët përveç rasteve, arritën t'i shënojnë edhe dy gola. Goli i parë erdhi në minutën e 12-të nga Osman Mëziu, i cili shënoi për 1-0, ndërsa Kreshnik Uka (19') shënoi për 2-0. Në pjesën e dytë,

përsëri ishin vendasit skuadër më e mirë duke krijuar më shumë dhe duke shënuar edhe katër gola tjerë. Goli i parë në këtë pjesë erdhi në minutën e 64-të me anë të Erdin Dushit që shënoi për 3-0. Uka (74') me golin e dytë personal shënoi për 4-0, ndërsa në minutën e 88-të kompletoi het-trikun. Rezultatit përfundimtar 6-0 e vulosi Bleon Sekiraqa me një gol në shtesë. Të shtunën Prishtina ka shënuar fitore ndaj Llapit, me rezultat 2:1, në një ndeshje që në fund ishte dramatike. Të tre golat e kësaj ndeshjeje u shënuan në pjesën e dytë. Prishtina kaloi në epërsi me golin e Besnik Krasniqit nga penalltia, në minutën e 47-të. Epërsinë e shtoi Endrit Krasniqi pas një aksioni të shkëlqyeshëm me Sadam Sulley, në minutën e 65-të. Megjithatë, llapjanët u këndellën në minutat e fundit, kur Drilon Fazliu realizoi pas asistimit të Kastriot Selmanit, në

minutën e 78-të. Në minutat shtesë llapjanët ishin shumë afër të barazojnë shifrat, por gjuajtja e Valmir Veliut qëlloi traversën e portës prishtinase. Në ndeshjen tjetër, Drita shënoi fitore në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan në duel me Ulpianën, me shifrat 3:2.

SUPERLIGA - JAVA 27

Gjilani - Ballkani	1-1 (Është ndërpre)
Drenica - Feronikeli	6-0
Prishtina - Llapi	2-1
Ulpiana - Drita	2-3
Dukagjini - Malisheva	0-0

TABELA

1. Ballkani	54 pikë
2. Drita	49
3. Gjilani	49
4. Llapi	41
5. Prishtina	35
6. Drenica	35
7. Malisheva	34
8. Dukagjini	30
9. Ulpiana	24
10. Feronikeli	12



Fitore e vlefshme për Bashkimin, Peja fiton derbin ndaj Trepçës

PRIZREN, 3 PRILL - Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 78:67 (17:19, 27:15, 19:16, 15:17), në xhiron e 25-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte shkëputjen e madhe, duke bërë që kjo pjesë të

përfundojë 17:19 për mysafirët. Por, në periudhën e dytë vendasit ishin më të mirë, duke pasur epërsi konstante, kurse rahovecasit tentonin të afrohen në rezultat, ndërsa pjesa e parë përfundoi me dhjetë pikë epërsi të vendasve 44:34. Prizrenasit në periodën e tretë ngritën epërsinë në 14 pikë, 53:39, e më pas

Vreshtarët afruan shifrat në 55:50, me një seri të suksesshme prej 2:11, por tetë pikë radhazi nga basketbollistët e Bashkimit bënë që rezultati në semafor pas 30 minutash të jetë 63:50. Në dhjetë minutat e fundit, Bashkimi ruajti epërsinë e krijuar, duke triumfuar në fund me rezultat 78:67. Te Bashkimi u

dalluan Terrence Thompson me 14 pikë e nëntë kërcime, Julien Lewis me 17 pikë dhe Alban Veseli me 15, kurse te Rahoveci u dalluan Musab Mala me 18 pikë dhe Fisnik Rugova me 17. Bashkimi ka dhjetë fitore e 15 humbje, kurse Rahoveci ka 11 fitore e 14 humbje. Ndërsa Peja ka shënuar fitore ndaj Trepçës me rezultat 79:71 (20:14,

20:18, 27:22, 12:17). Te Peja u dalluan Stephen Maxwell me 20 pikë e katër kërcime dhe Dardan Berisha me 26 pikë e tetë asistime, kurse te Trepça u dalluan Andrew Gordon me 12 pikë e 12 kërcime dhe Amin Hot me 10 pikë, gjashtë kërcime dhe gjashtë asistime. Peja ka 16 fitore e nëntë humbje, kurse Trepça ka 17 fitore e tetë humbje.

Interi fiton derbin e dominuar nga Juventusit

TORINO, 3 PRILL - Interi ka arritur që të marrë një fitore shumë të rëndësishme 1-0 në derbin ndaj Juventusit, edhe pse në fakt skuadra torineze e dominoi duelin. Juventusit e nisi më mirë ndeshjen duke dominuar në 30 minutat e para, duke krijuar shanse të mira me Vlahović si dhe Chiellini që do të ndalej vetëm nga shtylla pas një gabimi të Handanović. Në fundin e pjesës së parë do të vinte dhe momenti më vendimtar, me Interin që fiton penallti pas një faulli të Moratës. Ndërkohë që në ekzekutimin e parë Calhanoglu u ndal nga portieri i Juventusit.

Gjyqtari me VAR e ripërsëriti dhe më pas futbollisti turk arriti që të shënonte. Skuadra torineze ndërkohë e shtoi ndjeshëm presionin dhe në pjesën e dytë duke dominuar totalisht dhe duke krijuar shumë raste. Zakaria ju afrua shumë golit me një goditje që do të ndalej vetëm nga shtylla. Interi ndërkohë gjatë gjithë kohës vetëm mbrojti rezultatit, duke mos dalë thuajse në asnjë rast në sulm. Interi arriti të mbronte deri në fund rezultatit duke marrë 3 pikë që e mbajnë në vendin e tretë me 63 pikë, 3 më pak se Milani dhe Napoli.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "EnvriCon" Sh.p.k. Uglarë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mbledhjen, grumbullimin, maganizimin e mbeturinave metalike, vajrave mbeturinë, akumulatorëve, impianti për trajtimin e djegies së mbeturinave spitalore, medicinale, shtazore dhe organike të përgjithshme, impianti për trajtimin sterilizimin e mbeturinave në Harilaq komuna e Fushë Kosovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.04.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Holiday Resort"-sallën e takimeve në fshatin Sllatinë, Fushë Kosovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "EnvriCon" Sh.p.k. Uglarë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mbledhjen, grumbullimin, maganizimin e mbeturinave metalike, vajrave mbeturinë, akumulatorëve, impianti për trajtimin e djegies së mbeturinave spitalore, medicinale, shtazore dhe organike të përgjithshme, impianti për trajtimin sterilizimin e mbeturinave në Harilaq komuna e Fushë Kosovës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "EnvriCon" Sh.p.k. Uglarë, Graçanicë për mbledhjen, grumbullimin, maganizimin e mbeturinave metalike, vajrave mbeturinë, akumulatorëve, impianti për trajtimin e djegies së mbeturinave spitalore, medicinale, shtazore dhe organike të përgjithshme, impianti për trajtimin sterilizimin e mbeturinave në Harilaq komuna e Fushë Kosovës.

https://mmpi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit nr.08 të datës 28.03.2022, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 01.04.2022 të shpallë;

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

Një(1) Zyrtar/e Administrativ/e – Asistent/e në Njësinë punuese në Mitrovicë

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Kryen të gjitha punët e asistentit të cilat i përcakton Menaxheri i Njesisë ;
- Mban evidencën zyrtare të thirrjeve telefonike dhe takimeve;
- Pranon thirrjet dhe shkresat, kryen punët kompjuterike nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës;
- Punë tjera teknike që i cakton Menaxheri i Njesisë, siq janë shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve, arkivimi i dokumenteve dhe të postës për dorzim intern dhe ekstern, i të njejtave;
- Nëse është nevojë edhe qëndriminë më të gjatë se orari i rregullt i punës në raste të veçanta;
- Si dhe punë tjera të kësaj natyre, të cilat i përcakton sipas urdhëresës së eprorit të drejtpërdrejtë;
- Për punën që kryen i përgjigjet Menaxherit të Njesisë.

Kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:

- Të ketë Diplomë Universitare;
- CV-në
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj.mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 01.04.2022 deri më datën 17.04.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Jeton Bytyqi shpallë të pavlefshëm diplomën e studimeve (143/16) lëshuar nga Kolegji ISPE (09.06.2016) në Prishtinë.

▶ Albesian Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Elbasan Destani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Dy Dëshmorët" Pirane.

▶ Ahmet Jahdauti shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu "Qamil Guranjaku" Kushnin, Has.

▶ Malsor Idrizaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Rezonancës, drejtimi Inspektor Sanitar.

▶ Naim Haliti B.I. me Emri Tregtar: Zyre për Shërbime Juridike - Naim Haliti me seli në Prishtinë shpall të pavlefshme Certifikatën e regjistrimit me Numri Unik Identifikues: 810457409 të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

▶ Xhevat Abdullahi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Nëna Terezë" Vranidoll Prishtinë nga kl. I deri VIII .

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

